



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 7139 Prot.

Tiranë, më 05.08. 2019

Nr. Identifikimi 797

Vendimi 43

**DEKLARATË MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI:**

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Person juridik:** "Shell Upstream Albania B.V"  
**Nr. NIPT-i:** L21807009I  
**Adresa e selisë:** Nj.B. Nr. 2, Bvl. "B. Curri", European Trade Center, Kati 4, Tiranë  
**Personi përgjegjës:** Rohan D'Souza

Për të zhvilluar projektin: "**Vrojtim sizmik 2D në Bllokun 4, me linja të zgjatura në Blloqet 2-3**"

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", 14. Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror për qëllime tregtare, ku masa e nxjerrë e tejkalon nivelin prej 50 tonë/ditë në rastin e naftës dhe 10 000 m<sup>3</sup>/ditë në rastin e gazit.

**Vendndodhja:** Qarku Gjirokastrë

*(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

**Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

**1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:**

**Drejtoritë Teknike të Ministrisë së Mjedisit shprehen:** Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

**Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura:** Projekti i Vrojtimit Sizmik në Bllokun 4, rezulton se në të gjitha linjat e projektit ka prani të zonave të mbrojtura (ka dhe disa monumenteve natyrorë) dhe konkretisht:

- Linja nr. 17 SUA B44 011, kalon në Parkun Natyror (PN) "Zagori", prek në zonën qendrore (ZQ) dhe zonën e përdorimit tradicional (ZPT).
- Linja nr. 17 SUA B44 012, kalon në Parkun Natyror (PN) "Zagori", prek në zonën qendrore (ZQ) dhe zonën e përdorimit tradicional (ZPT) e cila vazhdon në Parkun Kombëtar (PK) "Bredhi i Hotovës - Dangëlli" dhe prek në Monumentet e Natyrës (MN) "Zhej" dhe "Vënjat e Konckës".
- Linja nr. 17 SUA B44 013, pjesa lindore e saj kalon në Parkun Kombëtar (PK) "Bredhi i Hotovës - Dangëlli" dhe Monumentin Natyror (MN) "Gropa e Kazanit".
- Linja nr. 17 SUA B44 014, kalon në Parkun Natyror (PN) "Zagori", prek në zonën qendrore (ZQ) dhe zonën e përdorimit tradicional (ZPT) si dhe prek në monumentin natyror (MN) "Zhej".
- Linja nr. 17 SUA B44 015, një pjesë e linjës kalon në zonën buferike të monumentit natyror (MN) "Selvia e Kishës".
- Linja nr. 17 SUA B44 016, nuk prek në asnjë zonë të mbrojtur dhe monument natyrorë.
- Linja nr. 17 SUA B44 017, kalon në Parkun Natyror "Zagori" duke prekur në zonën qendrore (ZQ) dhe zonën e përdorimit tradicional (ZPT), vazhdon në PK "Bredhi i Hotovës - Dangëlli" dhe në monumentin natyror "Zhej".

Sipas Ligjit nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", neni 16, "Për *Parqet Kombëtare*", pika 2 citon se: Në "Parkun Kombëtar" zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore të zonës që ka si objektiv, të mbajë territorin në gjendje natyrore, ku të ruhen komunitetet biotike të resurseve gjenetike dhe llojeve për të siguruar stabilitetin ekologjik dhe diversitetin ku:

- a) përjashtohet njeriu nga shfrytëzimi ose zënia me aktivitete intensive;
- b) nuk lejohet shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës;
- c) janë të ndaluara ndërtimi i zonave urbane, i autostradave, hekurudhave, linjave të prodhimit të energjisë, si hidrocentrale, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës e të gazit me shtrirje të gjatë.

Për *Monumentet Natyrorë*, sipas këtij ligji, neni 17, pika 2 citon se: Në një "Monument natyror" zbatohet shkalla e mbrojtjes, e njejtë me "Rezervën strikte". Zona mbrohet e menaxhohet për ruajtjen e karakteristikave dhe dukurive të veçanta natyrore, kulturore historike e arkeologjike, për të cilat



është shpallur monument. Mumentet natyrore rrethohen nga zona buferike me gjerësi deri në 200 metra nga perimetri i monumentit.

Për *Parqet natyrorë/Rezervate Natyrorë të Menaxhuar*, neni 19, pika 3 citon se: Në “Parkun natyror” nuk lejohet të zhvillohen aktivitetet e mëposhtme;

a) ndryshimet e gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve dhe sistemeve ligatinore;

b) shfrytëzimi dhe zënia e zonës me aktivitete që bien ndesh me qëllimet për të cilat ajo është marrë në mbrojtje.

Për këtë arsye kërkohet që subjekti “Shell Upstram Albania B.V”, të shmangë (devijojë) nga linjat e transekteve të saj Monumentet e Natyrës të sipërpërmendur si dhe zonën qendrore të Parkut. Subjekti të mos përdorë mjete dhe teknologji që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në natyrë dhe biodiversitet, e që sjellin ndryshime në strukturë e funksion të ekosistemeve. AKZM kërkon nga subjekti që gjatë kryerjes së proceseve kërkimore të këtij projekti, të mbahen parasysh dhe të zbatohen:

- Operacionet e vërtetimit-kërkimit për hidrokarburet, të realizohen nëpërmjet vendosjes së gjeofonëve në sipërfaqe, për të evituar maksimalisht dëmtimet natyrore në mjedis.
- Të mos priten pemë, por të adaptohen kërkimet në sipërfaqe pa bimësi të lartë (të mos priten pemë të shëndetshme, por kur është e pamundur, të mundësohet heqja e atyre të thara, të thyera, rrëzuara dhe degraduara biologjikisht).
- Për rastet kur do të kryhen gërmime në sipërfaqe të tokës, menjëherë pas përfundimit të operacionit të kërkim - vërtimit, të rehabilitohet e gjithë sipërfaqja e aksidentuar (nivelimi dhe sheshimi i sipërfaqes së aksidentuar).
- Koha e kryerjes së procesit të vërtimit të bëhet gjatë orëve kur fauna e egër është në lëvizje dhe kërkim të ushqimit, kjo për të evituar trembjen e tyre në kohën kur janë në pushim apo gjumë (fjetje).
- Mjetet motorrike që do të lëvizin në zonë duhet të jenë me goma dhe jo zinxhirë, për të evituar dëmtimin e sipërfaqes së tokës.
- Lëvizja e personelit tuaj që do të realizojë punimet në terren gjatë operacionit të kërkim - vërtimit, veçanërisht në zonat qendrore, (të cilat janë me ndjeshmëri të lartë), të bëhet vetëm në këmbë duke shfrytëzuar rrugët këmbësore ekzistuese si dhe çeltirat (sipërfaqet boshe) në zonë.
- AKZM/AdZM Gjirokastër, kërkon që në përfundim të gjithë procesit të vërtimit - kërkimit në terren, subjekti juaj ka detyrimin ligjor të kryej rehabilitimin mjedisor në të gjithë zonës e aksidentuar gjatë këtij operacioni.
- Procesi i vërtimit – kërkimit, duhet të realizohet në bashkëpunim të vazhdueshëm me AdZM-në Gjirokastër, e cila në përfundim të këtij procesi do të mbajë në prani me përfaqësues të subjektit tuaj, proces verbalin e marrjes në dorëzim të zonës, e cila duhet të jetë e rehabilituar dhe rikthyer në gjendjen e mëparshme fizike.

## **2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

*Konsultimi me publikun:* Dëgjesa me publikun u zhvillua për fazën e vërtitimit sizmike. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve. **Kërkesat e pjesëmarrësve, do të mbahen parasysh, në fazën kur shoqëria do të fillojë procedurat për fazën e shfrytëzimit.**

### **3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**

Zhvillimi i projektit është pjesë e aktiviteteve të parashikuara në Kontratën me Ndarje Prodhimi për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e hidrokarbureve në Bllokun 4, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 350, datë: 12.06.2018.

### **4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme.**

- 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 4.2 Kjo deklaratë është e vlefshme pas miratimit nga institucionet përkatëse. Aktiviteti të zhvillohet vetëm brenda sipërfaqjes dhe koordinatave të kërkuara në aplikim.
- 4.3 Subjekti duhet të tregoj kujdes të veçantë me monumentet e natyrës të cilt ndodhen në zonë.
- 4.4 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëj heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.
- 4.5 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kopetente.
- 4.6 Subjekti të zbatojë me korrektësi kërkesat e Legjislacionit Shqipëtar për mbrojtjen e mjedisit dhe komunitetit.
- 4.7 Para fillimit të zbatimit të projektit në terren, të hartohet Plani i Menaxhimit Mjedisor.
- 4.8 Kompania të ndjek me përpikmëri projektin për të evituar rrëshkitjet e dherave dhe aksidentet e mundshme.
- 4.9 Proçesi teknologjik të kryhet në bazë të studimeve gjeologjike dhe hidrologjike për të shmangur në maksimum dëmtimin e burimeve ujore, devijimin e rrymave ujore, erozionin dhe dëmtimin e zonave përreth.
- 4.10 Proçesi i shpimit të pusit të mos dëmtojë vepra dhe infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe objekteve të tjera në afërsi, barriera mbrojtëse, tubacione ujësjellesi kanale etj.
- 4.11 Ndalohet kategorikisht shkarkimi i mbetjeve në shtratin e lumit ne rast se gjenerohen te tilla.

#### **Gjatë fazës së instalimit:**

- 4.12 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangjen e aksidenteve njerëzore
- 4.13 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.14 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.15 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.16 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.



- 4.17 Të sistemohen brenda sipërfaqjes së shfrytëzimi të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës
- 4.18 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.19 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.20 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njëسيا vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- 4.21 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.22 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.23 Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- 4.24 Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit nr. 60/2014 datë 19.6.2014, "Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për Lejet e Mjedisit", të ndryshuar, Shtojca I, duhet t'i nënshtrohet procedurave për paisje me Leje Mjedisore.

*Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 "Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së", ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.*

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**  
**EDISON KONOMI**



**MINISTRI**  
**BLENDI KLOSI**



Aneksi 1. Harta me koordinatat

